



**OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA
DREJTORIA TEKNIKE**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ 2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

10.10.2024

Drejtuar: Operatorit ekonomik “KRIJON” sh.p.k., me NUIS K12023001A, me adresë “Farkë, Rruga e Elbasanit, nr.57, Çollak, 1044, Tiranë”.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, kontratë.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-18007-09-04-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje Gas - Chromatograph për Agjencinë Kombetare të Duhan – Cigareve”, me afat i zbatimi brenda 120 (njëqind e njëzet) ditëve nga data e lidhjes së kontratës me Autoritetin Kontraktor përfitues, me fond limit 7,050,000 (shtatë milion e pesëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.

Publikimet e mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 58, datë 09.09.2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. “KRIJON” sh.p.k.
Emri i plotë i shoqërisë

K12023001A
Numri i NIPT-it

Vlera 6,900,000 (gjashtë milion e nëntëqind mijë) lekë pa TVSH.

2. “MEDFAU” sh.p.k.
Emri i plotë i shoqërisë

J93610823R
Numri i NIPT-it

Vlera 6,000,000 (gjashtë milion) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1. “MEDFAU” sh.p.k.
Emri i plotë i shoqërisë

J93610823R
Numri i NIPT-it

Vlera 6,000,000 (gjashtë milion) lekë pa TVSH.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtëme:

1. Operatori Ekonomik nuk përmbush Kriteret e Veçanta për Kualifikim, në pikën 2.3 Kapaciteti Teknik, nënpika 2.3.5 e cila përcakton:

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për instalimin/vënien në punë të pajisjes laboratorike dhe trajnimin e stafit të Autoriteti Kontraktor përfitues, sipas përcaktimeve të bëra në shtojcën Nr. 5, duhet të disponojë minimalisht 1 (një) specialist të pajisur me certifikate/çdo dokument tjetër që të vërtetojë trajnimin/kualifikimin për pajisje Gas - Chromatograph, ose ekuivalente.

Për plotësimin e këtij kriti OE nuk ka paraqitur deklaratë sipas kërkesë dhe nuk ka deklaruar në Formularin e Vetdeklarimit se ka një specialist të certifikuar për trajnimin e stafit. Operatori Ekonomik nuk plotëson Kërkesat e Veçanta për kualifikim pika 2.3.5.

2. Operatori Ekonomik nuk përmbush Kriteret e Veçanta për Kualifikim, në pikën 2.3 Kapaciteti Teknik, nënpika 2.3.3 e cila përcakton:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog / skedë teknike për mallin objekt prokurimi ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat e mallit që do të ofrohet, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmeria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit. Katalogu duhet të jetë në gjuhën shqipe ose atë angleze.

Për plotësimin e kësaj pike OE ka ngarkuar në SPE katalog të përkthyer në gjuhën shqipe, të pamarkuar për pasijen që ofron PerkinElmer GC 2400. Nga vlerësimi i katalogut dhe krahasimi i specifikimeve teknike me specifikimet e paisjes së ofruar nga specialisti i fushën konstatohet se:

- Pasija e ofruar nga OE “MEDFAU” sh.p.k PerkinElmer GC 2400 përmbush pjesërisht specifikimet teknike të GC të kërkuar .

Laboratori i AKDC punon me metoda standarde ISO. Për testet që do te kryejë pajisja GC, përdorën përkatësisht S SH ISO 10315 dhe S SH ISO 10362, të cilat janë metoda që përcaktojnë përbërësit e tymit të cigareve. Bazuar në këto metoda GC kërkon dedektore FID dhe TCD.

Pajisja e ofruar ka dy dedektorë : FID dhe ECD. Dedektori ECD (Electron Capture Detector) është një dedektor selektiv, i rekomanduar kryesisht për analizat e komponimeve klor-organike sic janë pesticidet, PCB(komponime clororganike), etj. Ai nuk perdoret për përcaktimin komponimeve që gjenden në tymin e cigareve(ne ratin tone lageshtise ne tym). Për këtë qëllim përdoret dedektori TCD (Thermal Conductivity Detector) i cili nuk është pjesë e aparatit.

Në konkluzion vleresojmë se: Pajisja PerkinElmer GC 2400 nuk plotëson kërkesat e AK.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “KRIJON” sh.p.k., me NUIS K12023001A, me adresë “Farkë, Rruga e Elbasanit, nr.57, Çollak, 1044, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 6,900,000 (gjashtë milion e nëntëqind mijë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Agjencisë Kombëtare të Duhan Cigareve me adresë: Rruga “Siri Kodra”, Tiranë*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda afatit që do t’iu njoftohet nga autoriteti kontraktor përfitues.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO X

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO X

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)_____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR